



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Selmans Network” Sh.P.K. të datës 22.04.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 16.04.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Mirëmbajtja e ashensorëve për objektet e Komunës së Prishtinës dhe Mirëmbajtja e ashensorëve për objektet e banimit kolektiv (Lot 1)” me nr. të prokurimit 616-23-4207-269-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Selmans Network” Sh.P.K. e datës 22.04.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 16.04.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Mirëmbajtja e ashensorëve për objektet e Komunës së Prishtinës dhe Mirëmbajtja e ashensorëve për objektet e banimit kolektiv (Lot 1)” me nr. të prokurimit 616-23-4207-269-2-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “Selmans Network” Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Selmans Network” Sh.P.K. (tutje “parashtruesi”) me datë 22.04.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 16.04.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Mirëmbajtja e ashensorëve për objektet e Komunës së Prishtinës dhe Mirëmbajtja e ashensorëve për objektet e banimit kolektiv (Lot 1)” me nr. të prokurimit 616-23-4207-269-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit: parashtruesi ka kundërshtuar arsyet për eliminimin nga aktiviteti i prokurimit me pretendimin se *"ISO të dorëzuara nga SELMANS Network plotësojnë në përpikmëri të gjitha kërkesat sa i përketë kësaj pike"*.

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsyet si në vijim:

Grup i Operatorëve Ekonomik SELMANS NETWORK SH.P.K.; Romay Lift SH.P.K. sipas vendimit të OSHP me nr. 0554 nuk ka plotësuar kriteret si në vijim: Certifikatat ISO standard nuk janë përmbushur sipas natyrës së aktivitetit të Prokurimit.

Fillimisht duhet sqaruar se njoftimit mbi vendimit kundër të cilit është drejtuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit, i ka paraprirë edhe një vendimi me shenjë 2023/0554 i marrë nga OSHP me datë 24.11.2023. Përmes këtij vendimi ndër të tjera është përcaktuar se *"Paneli shqyrtues konstaton se OE i rekomanduar (Selmans Network) nuk i ka plotësuar kërkesat e pikës 3 ,Kërkesat dhe mundësit teknike e profesionale te DT, pasi OE i rekomanduar (Selmans Network) nuk i ka dorëzuar Certifikatat ISO Standardet e Liderit te grupit, certifikata këto të cilat nuk përkojnë me kërkesat e DT për mirëmbajtje të ashensorë, e cila është kërkesë e rregullores se cituar, po ashtu, parashihet se secili anëtar i grupit duhet të dëshmojnë standardet përkatëse, kërkesë kjo e cila është e ndërlidhur me nenin 70 të LPP dhe me cilësit që duhet të posedojë OE, andaj, konform nenit 26.6 të RRPP, OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar kërkesën e përcaktuar në Dosje të Tenderit. Kjo çështje është e sqaruar edhe në interpretimin e nxjerru nga KRPP më 22.06.2023, i renditur me nr. rendor 29, dhe i cili është i publikuar ne ueb faqen e eprokurimit"*. Ngjashëm edhe eksperti shqyrtues lidhur me këtë lëndë në OSHP kishte konstatuar se *"Raporti i eksperti shqyrtues, pasi analizimit të pretendimit të pare ankimor lidhur Certifikatat ISO Standardet e Liderit te grupit, vlerëson se qëndron pretendimi i OE ankues, për faktin se i rekomanduari për kontrate ka dorëzuar dy certifikata ISO standarde, të lëshuara me datën njëra me 28.4.2021 dhe tjetra me datën 8.09.2022 në të cilat jepet një përshkrim i përmbajtjes i validitetin të tyre për shërbimet, por ne asnjërën nuk përmendet konkretisht shërbimi mirëmbajtja e ashensorëve"*.

Kërkesa për të cilën bëhet fjalë në këtë rast është formuluar në dosjen e tenderit si vijon:

| | |
|--|--|
| <p>3. Operatori Ekonomik duhet të posedoj ISO STANDARDET që lidhen me natyrën e aktivitetit për LOT1 dhe LOT2 si në vijim a) ISO 9001 2015; b) ISO 14001 2015; c) ISO OHSAS 18001.</p> | <p>3. Kopjen e certifikatave ISO STANDARD me validitet dhe me weblink për verifikim.</p> |
|--|--|

Nga administrimi i dokumenteve me të cilat ka ofertuar parashtruesi është gjetur se parashtruesi në cilësinë e liderit të GOE tenderues nuk ka dorëzuar çertifikatat e kërkuara me dosjen e tenderit ndërsa ato çertifikata të cilat i ka dorëzuar (që janë vetëm dy) nuk ndërliidhen me natyrën e aktivitetit të prokurimit sikurse kërkohet me dosje të tenderit.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 24.04.2024

Visar SHEHU
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.